



ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS



OVLUÇK
Nr.prot. 01 / 2010
Datë: 06 / 04 / 2010
Prishtinë
Lënda: **Reagim**

Adresa: Rr.UÇK .nr.2
Tel:038/ 716 739
Fax: 038/ 716 749
Mobil:044/ 193 404
ovluck@hotmail.com

Për: Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Nga: Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së

Lënda: Reagim

REAGIM

Me datë 18 mars 2010, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, merr aktgjykimin Nr. KO 01/09, me të cilin në pikën 3 të këtij aktgjykimi VENDOS që neni 7 i Statutit të Komunës së Prizrenit, nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe urdhëron Komunën e Prizrenit që brenda një periudhe tre muajshe, nga dorëzimi i këtij aktgjykimi, ta ndryshojë Statutin dhe emblemën e saj pika 4 dhe në arsyetimin nën pikën 54 i'a përkujton Komunës që në emblemën e saj në rreth të shënohet në të tri gjuhët, shqip, serbisht dhe turqisht: komuna, opstina dhe beledye, pa e cekur vitin 1878! Për shtëpi nuk bëhet fjalë!?

Fjala është për kërkesë për vlerësim të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së zëvendëskryesuesit për komunitete në Komunën e Prizrenit, Qemajl Kurtishi, i cili decidivisht kërkon që të shlyhet tërësisht neni 7 i Statutit të Komunës së Prizrenit, i miratuar më 15 tetor 2008, ku thuhet “ Komuna ka emblemën, flamurin dhe simbolet e saj”. Çudi, ky “autoritet” nuk e atakon vendimin e MAPL-së si aktin përfundimtar administrativ e që gjykata është dashur ta kanalizojë ashtu siç e kërkon procedura e këtyre rasteve!

Emblema e Komunës është “ Shtëpia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” e rrethuar me në vijim “1878” –Prizren”

Na habit fakti se ky aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës mbanë numrin rendor të lëndës nën një (Nr. KO 01/09.) Pra si duket aktgjykimi i parë i saj! Punë e mbarë dhe ... !

Poashtu na habit fakti se, në një gjykatë që punojnë intelektualë të kalibrit kaq të madh, të mos e kuptojnë se ç'është emblema dhe simbolet, vërtetë nuk është edhe pa prapavijë politike. Kjo gjykatë, në rastin konkret, nuk e ka pasur në fushëveprimin e vet, vlerësimin e vendimit të MAPL-së, si akt politik por administrativ. Pa u lëshuar në vlerësimin e këtij akti dhe ligji, për ta ndërruar atë dispozitë në Ligjin e punës së MAPL, që na qenka në kundërshtim me Kushtetutën, gjithsesi kjo gjykatë nxjerr aktgjykim të paligjshëm. Së paku, kjo gjykatë është dashur ta dijë se pa e ndal burimin juridik, që kinse ka prodhuar pasoja joligjore, nuk mund t'i eliminojë aktet e tjera administrative, që burojnë nga këto dispozita të këtij ligji në fuqi. Është shumë indikativ mendimi i gjyqtarit z. Almiro Rodrigues si referues, kur ironizon me fjalët “ dukej se ky mendim i MAPL-së, se të gjitha çështjet ishin adresuar si duhet nga ana e komunës dhe çdo gjë ishte në rregull” !?. Por, siç thekson në vijim në pikën 22 “ Se qysh më 27 nëntor 2008, Komunës i ishte bërë me dije se ekzistonte një shqetësim, ishin ngritur pyetje të rëndësishme mbi nivelin e

duhur të konsultimit publik”. Pra, ai publikisht nuk guxon ta citojë se pa konsultimin me popullatën e kësaj Komune, e cila do të aprovonte vullnetin e shumicës me REFERENDUM, që është akt më i madh dhe më i drejtë dhe valid se çdo dispozitë apo vendim i secilës gjykatë, dhe detyrueshëm në zbatim nga të gjitha organet e pushtetit që respektojnë vullnetin e popullit, e në bazë të cilit vullnet janë krijuar dhe punojnë të gjitha organet administrative e gjyqësore. Ky vendim i kësaj ministrie ngelet me dilema! Neni 57 -3 i Kushtetutës shprehimisht i’u jep anëtarëve të komuniteteve “ të drejtën e shprehjes së lirë, nxijtjes dhe zhvillimit të identitetit dhe atributëve të komuniteteve... të inkurajojnë dhe sigurojnë pjesëmarrjen e TE GJITHË QYTETARËVE NË PROCESIN E VENDIM-MARRJES NGA ORGANET KOMUNALE”

OVL e UÇK-së, pajtohet, që kjo çështje të zgjidhet në pajtim me pjesëmarrjen e GJITHË QYTETARËVE të Komunës së Prizrenit,(por edhe të tërë Kosovës, meqë kemi të bëjmë me simbolin e formimit të kombit shqiptar) dhe të shohim se a është dashur të merret një aktgjykim imponues i këtillë nga kjo gjykatë, për heqjen e vitit shumë të rëndësishëm historiko –kombëtar, për popujt e trevave të 6 vilajeteve turke, ku jetonin shqiptarët me shumicë, të robëruar nga Perandoria Osmane e mëpastaj ajo Sllave e që në vitin 1878 në Prizren u proklamua vullneti i shenjtë i kombit shqiptar, gjithnjë me shumicë, për liri e pavarësi.

Shkelqyeshëm keni vepruar me renditjen e të gjitha Konventave dhe Deklaratave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (Neni 22) dhe posaçërisht të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strazburg. Do t’i ishim mirënjohës zotit referues, sikur të kishte gjetur një pikë apo nen ose shtet, ku në këto akte ndërkombëtare favorizohen komunitetet apo pakicat në ndonjë vend me diskriminim pozitiv si ato në Kosovë!? A thua në vendin e tij ka ndonjë rast të këtillë?. Siç dihet, çdo jurist i këtyre organeve , gjithsesi duhet ta praktikojë, nëpër aktgjykime të rangut të këtillë, të cekë shembujt e tillë, për të mos bërë presedencë! Andaj, edhe mendimin e një individi i cili si duket ose ka qenë në dhjetë mbledhjet e delegacionit të Millosheviqit, në vitin 1989,në bisedimet me “separatistët dhe irredentistët” shqiptarë të Kosovës, apo ka bërë sehir në ndërmarrjen e parë të marrjes të masave të dhunshme në Kosovë, ndaj një institucioni historiko-politik, pra Shtëpisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit . Pra, të reagonte ashtu siç pati bërë më vonë edhe kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Fakultetin Juridik të Prishtinës, ndaj masave të dhunshme në Fakultetin juridik të Prishtinës. Mirëfilli e dijmë se atëbotë edhe ky kryetar, pati reaguar ndaj kësaj mase padrejtësie brutale e shkatërrimtare, ndaj një populli. Ku na ishte zoti inicues i këtij procesi, kur plaçkitez kjo shtëpi me plot material historiko-politik nga serbët? Apo, kur mëpastaj edhe e kallen rrafsh me tokë, në vitin 1998? Apo ndoshta indirekt ka ndikuar në ato delegacione, dhe tani i trimëruar merr edhe përkrahjen madje, në emër të qytetarëve (?) të Prizrenit, nga ana e kësaj gjykate që t’i “dëgjojnë dhe respektojnë mendimet e tij” ose të një dyshimi në përcaktim kombëtar të një anëtarë të kësaj gjykate, që të parët e tij, kanë lindur në një fshat mbi 20 kilometra në Shqipëri, ku nuk ka pasur kurrë turqë dhe nuk ka asnjë, e që tani turqizohen në Prizren! Aferim!

Për OVL-UÇK-në, ngelet një vragë historikisht e pashlyeshme dhe e paharrueshme, gjeneratë pas gjenerate, kur një organ i drejtësisë më të lartë, tenton të shlyej historinë, përmes “argatëve “ të huaj, duke mos ditur se përmes këtij veprimi po e shlyen edhe historinë e popullit shqiptar, vetveten dhe institucionin. Këtë do ta vërtetojë edhe vet

populli shumë shpejt. Lidhja e Prizrenit nuk ka qenë asnjëherë asgjë tjetër, pos simbol i identifikimit të parë të krijimit të popullit dhe kombit shqiptar me kufijtë etnik. 10 Qershor 1878, nuk paraqet asgjë tjetër, pos datës kur lind e rritet ky komb, në të gjitha trevat shqiptare, ku është marrë vendimi se në Ballkan, ekziston edhe shteti shqiptar si popull e komb, me kryeqytet Prizrenin, i cili edhe pas Luftës së Dytë Botërore do të jetë i tillë, i cili historikisht gjithnjë banohej me shumicë shqiptare. Ka vdekur koha kur shovenizmi i Komitetit “ JEUNE-TURK” turk, apo ai i “ Dorës së Zezë” serbe, “Megalloideas” të një Venezilosi, e “ Patkoi” të Millosheviqit, se SHQIPTARË në Ballkan nuk ka, por ata janë një popull anadollak i muslimanizuar!

Ju gjyqtarë dhe institucion gjyqësor, të jeni të bindur se OVL e UÇK-së, në asnjë moment apo formë tjetër nuk do të bindet që nga emblema e komunës së Prizrenit të shlyhet data historike e lindjes së popullit dhe kombit shqiptar 1878, dhe vendi ku u kurorëzua kjo fitore e rilindasve patriotë, të cilët e shpallen këtë ditë historike për kombin tonë, dikur i mbyllën në burgun e Kalasë së Prizrenit, por asnjëherë nuk e mohuan veprën e tyre. Ne jemi mësuar historikisht me këso avaze ndjellakeqe, të fatkeqësive të gjakosura por mos harroni se ende nuk janë shlyer as për së afërmi, gjurmët e gjakut të derdhur për liri, që neve që e kemi përjetuar këtë, na obligon të jemi gjithnjë vigjilent dhe të gatshëm në ruatjen e vlerave historike të luftës për liri, në të kaluarën por edhe në të sotmen. Jemi të gatshëm që për çdo eventualitet, madje edhe me pasoja të mundshme, në ruatje të atdheut dhe vlerave historike të tij. Një gjest të tillë, me të parën e bëri Gjykata më e lartë e Kosovës, e cila me pamaturinë e saj apo me qëllim nxitjeje të këtyre reagimeve dhe e cila ende nuk di ta dallojë emblemën nga simboli, apo t'i vlerësojë simbolet historike, siç do të bënte referuesi Almiro Rodrigues në atdheun e tij!

Le të jetë e gjithëdijshe se ne OVL e UÇK-së, do të jemi në ballë të mjetit juridik të shpalljes së REFERENDUMIT në Komunën e Prizrenit apo në tërë Kosovën, sipas nenit 57 pika 3 e Kushtetutës, ku do të shohim “shqetësimin e popullit” të Prizrenit apo të Kosovës, siç na përrallon referuesi Almiro Rodrigues, ku vet qytetarët do të vendosin me shumicë se cila emblemë do të jetë e përdorshme për ta, në këtë Komunë. E dijmë se një vendim të plotëfuqishëm të kësaj gjykate, do ta anulojmë vetëm me referendum, ku vullneti i popullit, si mjeti juridiko-politik, më i lartë edhe se vet shteti, nxjerr vendimin më valid se çdo institucion shtetëror. Kjo, njëkohësisht do të reflektonte edhe aftësitë e organeve udhëheqëse në Kosovë, tani pas Pavarësisë, se si t'i zgjidhin çështjet më madhore dhe me çfarë kuadro?

Edhe një herë, Ne kërkojmë që për këtë çështje të mbahet referendum në Komunën e Prizrenit, ku qytetarët do të shprehin vullnetin e tyre, përndryshe, çdo hap tjetër i cilitdo organ në Kosovë, që vepron në kundërshtim me vullnetin e popullit, do të na gjejë të mobilizuar, në ndihmë popullit. Jemi këtu...

Prishtinë, më
6 prill 2010

Kryesia e OVL të UÇK-së

Muharrem Xhemajli, Kryetar